

# Programi suedez i vaksinimeve

## PJESA E CAKTUAR PËR DISA FËMIJË

Të gjithë fëmijët në Suedi kanë të drejtë vaksinimi kundër nëntë sëmundjeve serioze përmes Shëndetësisë së fëmijëve dhe Shëndetësisë shkollore (lexo fletën e veçantë të informacionit)

Pos kësaj, disa fëmijëve iu ofrohet vaksinimi kundër hepatitit B, tuberkulozës, gripit dhe infeksionit të pneumokokeve.

### HEPATITI B

Hepatiti B është një nga shumë viruset të cilët shkaktojnë pezmatim të mëlçisë. Shpërndarja ndodh nëpërmjet gjakut dhe të lëngjeve tjera të trupit. Tek një pjesë e të infektuarve, sëmundja nuk vërehet aspak ndërsa të tjerët mund të sëmuren seriozisht gjatë shumë muajve. Shumica shërohen sërish, por te disa, viruset mbeten në trup dhe mundet që shumë më vonë të shkaktojnë komplikacione si dëmtime të mëlçisë ose kancer në mëlçi. Rreziku është më i madh për ata që janë infektuar me hepatit B në moshë rinore.

#### Cilët bëjnë mirë të vaksinohen?

Vaksinimi iu rekomandohet fëmijëve të cilët në rrethin e tyre të afërt si p.sh. prindërit, farefis ose persona tjerë kanë hepatit B, ose për fëmijë, prindërit e të cilëve janë nga vende ku hepatiti B është më i zakonshëm se në Suedi.

#### Çfarë mbrojtjeje jep vakcina?

Vaksinimet janë shumë efektive dhe pothuajse të gjithë fëmijët që vaksinohen krijojnë një mbrojtje. Mbrojtja është afatgjatë- me siguri gjatë tërë jetës.

#### Cilat vakcina jepen kundër hepatitit B?

Vakcina jepet si vaksinë e veçantë. Për vaksinim të foshnjave ekziston edhe një vaksinë e kombinuar ku përfshihet edhe vakcina kundër hepatitit B.

#### Kur jepet vakcina?

Vakcina jepet zakonisht gjatë tre rasteve, ose së bashku me vaksinimet tjera gjatë foshnjërisë (pas 3, 5 dhe 12 muajsh) ose sipas një orari të ndarë.

#### Cilat janë efektet anësore?

Tek shumica e fëmijëve nga vaksinimet kundër hepatitit B nuk krijohen efekte anësore ose ka efekte anësore të parëndësishme. Efektet e mundshme anësore kalojnë zakonisht pas disa ditëve.

**TË RËNDOMTA** (vërehet tek të paktën 1 nga 100 të vaksinuar): kuqje, ënjtje dhe dhembje aty ky është injektuar shiringa.

**TË PAZAKONSHME OSE TË RRALLA:** zjarmi, kruarje, kokëdhembje, diarje, kurtesh në lëkurë, reaksion alergjik.

### TUBERKULOZA

Tuberkuloza është një sëmundje të shkaktohet nga një bakterie. Ajo sulmon zakonisht mushkëritë, por edhe organet e tjera. Tuberkuloza përhapet zakonisht përmes ajrit gjatë kollitjeve. Zhvillimi i sëmundjes është në shumicën e rasteve i ngadalshëm me kollitje gjatë një kohe të gjatë, dobësim peshe dhe temperaturë. Sëmundja mund të mbetet edhe latente në trup për shumë vjet, për të shpërthyer pastaj sërish. Tuberkuloza në formë latente nuk është ngjitesë.

#### Cilët bëjnë mirë të vaksinohen?

Vaksinimi u rekomandohet fëmijëve të shëndoshë të cilët në rrethin e tyre të afërt, p.sh. ndër prindër, farefis ose persona tjerë kanë tuberkulozë, ose për fëmijë prindërit e të cilëve janë nga vende ku tuberkuloza është më e zakonshme se sa në Suedi.

#### Çfarë mbrojtjeje jep vakcina?

Vakcina jep një mbrojtje të mirë për fëmijë të vegjël kundër llojeve të vështira të tuberkulozës. Mbrojtja për moshat më madhore është diskutabile dhe shumë e shumëllojshme.

#### Cilat vakcina jepen kundër tuberkulozës?

Vakcina ekziston si një vaksinë e veçantë.

#### Kur jepet vakcina?

Vakcina jepet zakonisht si një dozë e një hershme prej moshës 6 muajshe, por duhet të jepet edhe më herët në rast të një rreziku të lartë për infeksion.

#### Çka ndodh pas vaksinimit?

Vaksinimi do të thotë krijimi i një infeksioni të vogël në lëkurë. Dy deri katër javë pas vaksinimit, një përforsim i vogël shfaqet në vendin e injeksionit. Përforsimi bëhet i kuq dhe rritet, pas një kohe krijohet një plagë prej ku mund të rrjedhë qelb. Plaga duhet lënë e paprekur që pas disa javëve të shërohet vetvetiu. Shmangu nga larjet në pishina përderisa plaga ende është e hapur. Tek disa fëmijë nuk krijohet ndonjë plagë por vetëm një përforsim që zhduket pas ndonjë apo disa muajsh.

#### Çfarë pasojash ka?

**TË PAZAKONSHME OSE TË RRALLA:** një plagë e madhe e pazakonshme për të cilën duhet një kohë e gjatë për t'u shëruar, zjarmi, kokëdhembje, reaksion alergjik.

## GRIPI

Gripi është një infektion te bronket që krijohet nga viruset. Ai përhapet zakonisht përmes ajrit kur i sëmuri kollitet ose teshtinë. Çdo dimër gripi prek vendin tonë dhe dy deri në pesëmbëdhjetë përqind sëmuren. Gripi kalon zakonisht vetvetiu, por një sëmundje pasuese e rëndomtë është pneumonia.

### Cilët bëjnë mirë të vaksinohen?

Pos të moshuarve mbi 65 vjeç, vaksinimi u rekomandohet edhe të rriturve dhe fëmijëve me sëmundje kronike të zemrës e të mushkërive, me diabet jostabil, a me mbrojtje imunologjike të ulur rëndë. Edhe fëmijët me sëmundje tjera mund të vijnë në pyetje. Vlerësimi bëhet nga mjeku i fëmijës.

### Çfarë mbrojtjeje jep vakcina?

Pasi që viruset e gripit tërë kohës ndryshojnë në përbërje, para çdo sezoni duhet prodhuar një vaksinë e re që është efektive kundër viruseve që janë aktualë mu atëhere. Kjo dth që duhet vaksinuar çdo vit për të patur një mbrojtje sa më të mirë.

### Cilat vakcina jepen kundër gripit?

Ekzistojnë shumë lloje të ndryshme të vaksinave kundër gripit.

### Kur jepet vakcina?

Fëmijë mund të vaksinohen prej moshë 6 muajshe. Vakcina jepet si një dozë ose si dy, varësisht prej moshës së fëmijës.

### Cilat janë efektet anësore?

Vaksinat e gripit prodhohen nga viruse të kultivuar te vezët e pulave. Prandaj, kush ka alergji të fortë kundër vezëve bën mirë të mos marrë fare vaksinë kundër gripit.

Shumica e fëmijëve nuk kanë efekte anësore ose kanë efekte anësore të vogla që zakonisht kalojnë brenda disa ditëve.

**TË RËNDOMTA** (vërehet te të paktën 1 nga 100 të vaksinuar): kuqe, ënjtje dhe dhembje aty ku është injektuar shiringa, zjarmi.

**TË PAZAKONSHME OSE TË RRALLA:** reaksion alergjik.

## ME RËNDËSI

**Para vaksinimeve** – Trego në rast se fëmija yt është alergjik ose në rast se ka reaguar pazakonshëm gjatë vaksinimeve të mëhershme.

**Pas vaksinimeve** – Kontakto Shëndetësinë e fëmijëve ose Shëndetësinë shkollore në rast se vëren diçka të pazakonshme tek fëmija yt gjatë kohës më të afërt.

## PNEUMOKOKET

Pneumokoket janë bakterie që mund të shkaktojnë infeksione të lehta, si infeksione të veshëve dhe të sinusëve, por mund të shkaktojnë poashtu edhe sëmundje shumë serioze, në disa raste edhe vdekjeprurëse, si janë helmimi i gjakut dhe pezmatimi i cipës së trurit. Ka edhe rreziqe për komplikime, p. sh. dëmtime të dëgjimit ose forma të ndryshme të dëmtimeve trunore.

### Cilët duhet të vaksinohen?

Vaksinimi i përgjithshëm i foshnjeve ka nisur më 1 janar 2009. Fëmijë të cilët ende nuk janë vaksinuar dhe të cilët rrezikojnë të sëmuren rëndë nga pneumokoket, rekomandohet që të vaksinohen pa marrë parasysh moshën. Kjo vlen për p. sh. fëmijë me sëmundje kronike të zemrës, të mushkërive ose të veshkëve, të mungesës së lindur të imunitetit ose për fëmijë me implantat koklean te veshi. Vlerësimi bëhet nga mjeku i fëmijës.

### Çfarë mbrojtjeje jep vakcina?

Vaksinimi jep mbrojtje të mirë kundër pneumokokeve që bëjnë pjesë në secilën vaksinë.

### Cilat vakcina jepen kundër pneumokokeve?

Ekzistojnë dy lloje të ndryshme të vaksinave në treg. Një për fëmijët nën 5 vjeç dhe një për fëmijë mbi 2 vjeç dhe për të rritur.

### Kur jepet vakcina?

Vaksinimi për fëmijët e grupeve të rrezikuara bëhet sipas një orari të veçantë.

### Cilat janë efektet anësore?

Shumica e fëmijëve ose nuk kanë fare, ose kanë shumë pak efekte anësore nga vakcina kundër pneumokokeve. Efektet e mundshme anësore kalojnë zakonisht brenda disa ditëve.

**TË RËNDOMTA** (vërehet tek të paktën 1 nga 100 të vaksinuar): kuqe, ënjtje dhe dhembje aty ky është injektuar shiringa, zjarmi, diarre, vjellje.

**TË PAZAKONSHME OSE TË RRALLA:** reaksion akut i tejndjeshmërisë, kruarje, ngërçe të zjarmisë, kurtesh, zbeh-tësi dhe dobësim.

### Dëshiron të dishë më tepër?

Kontakto në radhë të parë më mjekun e fëmijës. Mund ta kontaktosh poashtu edhe me Shëndetësinë e fëmijëve ose Shëndetësinë shkollore.